

Në përputhje me pushtetin dhe autoritetin e akorduar me Nenet 5 dhe 6 të **Rregullores së UNMIK Nr. 2006/47** Mbi AQBK-në, **Rregullores së UNMIK Nr. 1999/4** Mbi Valutën e Lejuar për përdorim në Kosovë, **Direktivës Administrative të UNMIK Nr. 2001/24** mbi Ndryshimin e **Direktivës Administrative të UNMIK Nr. 1999/2** për Zbatimin e **Rregullores së UNMIK Nr. 1999/4** mbi Valutën e Lejuar për përdorim në Kosovë, dhe në përputhje me Rregullin e Këshillit të BE-së (KE) Nr. 1338/2001 të datës 28 qershor 2001 mbi vendosjen e masave për mbrojtjen e euros kundër falsifikimit, si edhe në përputhje me orientimet e Bordit Drejtues miratuar në takimin e tij të datës 20 maj 2004 dhe rikonfirmuar në takimin e tij të datës 26 janar 2005.

Nëpërmjet kësaj AQBK-ja amendon Udhëzimin Nr. 2 të datës 14 mars 2005:

Udhëzim Nr. 2 i Amenduar

Mbi Shmangien e Kartëmonedhave dhe Monedhave Euro të Falsifikuara nga Qarkullimi

Neni 1

Lëmi

Ky Udhëzim u adresohet të gjitha institucioneve financiare që veprojnë në Kosovë dhe që janë të liçensuara nga Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës (AQBK-ja).

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi është vendosja e masave të nevojshme për arsye të shmangies së kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara euro nga qarkullimi.

Neni 3

Përkufizimet

3.1. "Kartëmonedha të falsifikuara" dhe "monedha të falsifikuara" do të nënkuptojnë kartëmonedha dhe monedha të emërtuara në euro ose të cilat kanë pamjen e kartëmonedhave apo monedhave euro dhe të cilat janë bërë ose ndryshuar në mënyrë mashtruese.

3.2. "Autoriteti kompetent" do të nënkuptojë autoritetin (-et) e përcaktuara për hulumtimin dhe analizimin e kartëmonedhave dhe monedhave të dyshuara si të falsifikuara dhe kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara

3.3. "Të dhëna teknike dhe statistikore" do të nënkuptojë të dhënat me anë të të cilave kartëmonedhat e falsifikuara ose monedhat e falsifikuara mund të identifikohen (përshkrimi teknik i llojit të falsifikimit) dhe të dhënat mbi numrin e kartëmonedhave të falsifikuara dhe monedhave të falsifikuara në bazë të origjinës, veçanërisht gjeografikisht, dhe në bazë të datës.

Neni 4

Të Dhënat Teknike dhe Statistikore – Mbledhja dhe Qasja

- 4.1. Të dhënat teknike dhe statistikore lidhur me kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara të zbuluara nga institucionet financiare do të mblidhen dhe indeksohen.
- 4.2. AQBK-ja do të mbledhë dhe ruajë të dhënat teknike dhe statistikore lidhur me kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara të zbuluara brenda operimit të sektorit financiar.
- 4.3. AQBK-ja do të këmbëjë me autoritetin kompetent të dhënat teknike dhe statistikore, sipas një marrëveshjeje të veçantë
- 4.4. AQBK-ja do të themelojë Komitetin e Analizave të Falseve si një komitet të përbashkët me autoritetin kompetent me qëllim të koordinimit të mbledhjes dhe analizave të të dhënave teknike dhe statistikore dhe avancimit të masave që kanë të bëjnë me shmangien e kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara nga qarkullimi
- 4.5. AQBK-ja do t'i bëjë të disponueshme të dhënat teknike dhe statistikore për Bankën Qendrore Evropiane dhe/ose bankat qendrore kombëtare të eurozonës.

Neni 5

Detyrimet dhe Sanksionet

- 5.1. Institucionet financiare, konkretisht institucionet e kreditimit dhe çdo institucion tjetër i angazhuar me ndarjen dhe shpërndarjen e kartëmonedhave dhe monedhave publikut si një veprimtari profesionale, duke përfshirë institucionet, veprimtaria e së cilave konsiston në këmbimin e kartëmonedhave dhe monedhave të valutave të ndryshme, si p.sh. zyrat e këmbimit, do të jenë të detyruara të heqin nga qarkullimi të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat euro të pranuar prej tyre, të cilat ata i dinë ose kanë arsye të mjaftueshme të besojnë që janë të falsifikuara. Kartëmonedhat dhe monedhat e dyshura si të falsifikuara duhet menjëherë t'i dorëzohen autoritetit kompetent.
- 5.2. Institucionet financiare do të pranojnë informatë kthyesë nga autoriteti kompetent pas përfundimit të analizave të kartëmonedhave dhe monedhave të dyshuara si të falsifikuara që ata i kanë dorëzuar.
- 5.3. Institucionet financiare do të raportojnë në AQBK mbi kartëmonedhat dhe monedhat e dyshuara si të falsifikuara që kanë dorëzuar te autoriteti kompetent në baza mujore.
- 5.4. AQBK-ja do t'i marrë masat e nevojshme për të garantuar që institucionet e referuara në paragrafin 5.1., të cilat nuk arrijnë t'i zbatojnë detyrimet e tyre sipas paragrafit të lartpërmendur do t'u nënshtrohen sanksioneve efektive, të përpjesëshme dhe frenuese. AQBK-ja do të aplikojë një gjobë (ngjashëm me atë në eurozonë) ndaj çdo institucioni financiar që i lëshon klientit të tyre kartëmonedha dhe monedha të falsifikuara.

Neni 6

Bashkëpunimi dhe Ndhimja Reciproke

- 6.1. AQBK-ja do të nxisë bashkëpunimin me institucionet financiare dhe autoritetin kompetent me qëllim të:
 - Këmbimit të informatave mbi zbulimin dhe parandalimin e falsifikimit dhe luftimin kundër hedhjes në qarkullim të kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara;
 - Këshillimit të institucioneve financiare që të përdorin pajisje për verifikimin e kartëmonedhave, të cilat janë provuar në mënyrë të suksesshme nga bankat qendrore kombëtare të eurozonës; dhe
 - Sigurimit të ndihmës reciproke siç janë trajnimet e stafit mbi kartëmonedhat euro dhe veçoritë e tyre të sigurisë.

Neni 7

Hyrja në Fuqi

Ky Udhëzim i Amenduar do të hyjë në fuqi në datën 1 mars 2007.